



KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT

Në Tiranë, sot më datë 18. 02. 2005 (pesë), ditën e Premte, përpara meje noteres **Ruko SAKO**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rrugën e "Durrësit", u paraqitën personalisht palët e mëposhtme :

SHITËSI : **Z. Artan DULAKU**, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 30. 05. 1965, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, dhe banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar mbajtës i pasaportës me Nr. Z. 0031648.

BLERËSI : **Shoqëria "Alissa Costruzioni", Spa** : person juridik i huaj, Italian, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të Padovas, me Kod Fiskal dhe Nr. Regjistrimi 02532360282, R.E.A. 236359, me seli në Padova, adresën : Rruga "Trieste Nr. 32, CAP 35121, Itali, përfaqësuar nga Z. Graziano Bergamin, i datëlindjes 20. 07. 1951, lindur në Grantorto (PD), shtetas Italian, dhe banues në adresën : via Solferino, n.17, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kodin fiskal BRG GZN 51L20 E145M, në cilësinë e Administratorit Ligjor të Shoqërisë, ky i fundit i përfaqësuar nga Z. Andrea Bergamin, i datëlindjes 25. 12. 1975, lindur në Grantorto (PD), shtetas Italian, dhe banues në adresën : via Solferino, n.17, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kodin fiskal BRG NDR 75T25 B563R, në cilësinë e përfaqësuesit me posaçëm, të autorizuar nëpërmjet Prokurës së Posaçme me NR. 32880, datë 15. 02. 2005.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, në prani të perkthyeses së gjuhës italiane Edlira HYSENI, Unë noterë konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRAT SHITJEJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT, sipas kushteve dhe kriterëve të mëposhtme :

KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk, është regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Nr 32629, datë 24. 12. 2004, me Seli në Rrugën " Perlat Rexhepi", Zyra Nr. 6, në katin II, të Godinës me 2+13 Kate Tiranë, Shqipëri, dhe kapital themeltar të shoqërisë, në shumën 100,000 Lekë, me Ortak të Vetëm Z.Artan Dulaku i cili zotëron 100 % (njëqind përqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin e saj.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Z. Artan Dulaku, kërkon të shtojë ortakët e shoqërisë "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk dhe është plotësisht dakort që t'i shesë një pjesë të kuotave të tij, ortakut të ri, personit juridik, të mëposhtëm :

OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse Z. Artan Dulaku i cili zotëron 100% (njëqindpërqind) të pjesëve të kapitalit ose 100 (njëqind) kuota, në Shoqërinë "ALISSA COSTRUZION" Shpk, me dëshirën e tij dhe kërkesën e blerësit, i shet dhe i transferon palës Blerëse, Shoqërisë "ALISSA COSTRUZION" Spa, e cila pranon dhe ble 60% (gjashtëdhjetëpërqind) të pjesëve të kapitalit, ose 60 (gjashtëdhjetë) kuota, në kapitalin e Shoqërisë "ALISSA COSTRUZION" Shpk.

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

Pjesët prej 60% (Gjashtëdhjetëpërqind) të pjesëve të kapitalit, ose 60 (gjashtëdhjetë) kuota, në kapitalin e Shoqërisë "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk, të zotëruara prej Shitësit, shiten (transferohen) tek Blerësi, i cili pranon t'i blejë

kundrejt çmimit në vlerën prej totale prej 75,600 (Shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) Lekë, ku vlera nominale e 1 (një) kuote është 1260 (Një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) Lekë, për kuotë, vlerë për të cilin Blerësi nuk ka asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to, vlerë për të cilën Shitësi dhe Blerësi deklarojnë se janë likuiduar totalisht jashtë Zyrës së Notarisë.

KALIMI I PRONËSISË

Që nga momenti i nënshkrimit të kontratës, Ortakë të Shoqërisë "Alissa Costruzioni" Sh.p.k do të jenë Z. Artan Dulaku, me 40 % (dyzet përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar ose 40 (dyzet) kuota, dhe Shoqëria "Alissa Costruzioni" S.p.a me 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 60 (gjashtëdhjetë) kuota, të cilët të dy së bashku bëhen pronarë të vetëm me 100% (njëqindpërqind) të kapitalit, në kapitalin e Shoqërisë.

GARANCITË

Blerësi garanton Shitesin se pranon dispozitat e parashikuara në statutin e Shoqërisë "Alissa Costruzioni" Shpk, dhe garanton respektimin e plotë të tyre.

Në momentin që Shitësi arkëton çmimin e sipërpërmendur, ai humbet çdo të drejtë pronësie, dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 60 (gjashtëdhjetë) kuota, të Shoqërisë "Alissa Costruzioni" Shpk dhe Blerësi bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë ose 60 (gjashtëdhjetë) kuota, të Shoqërisë.

BAZA LIGJORE

Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Ligjit Nr. 7638, datë 19.12.1992 "Mbi Shoqëritë Tregëtare" dhe Ligjit Nr. 7667, datë 28. 01. 1993 Për regjistrin tregtar. Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlerfshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre.

HARTIMI I KONTRATËS

Kontrata përbëhet nga 2 (dy) fletë dhe hartohet në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe dhe italiane, në rast konflikti ndërmjet palëve, gjuha bazë për interpretimin e kontratës do të jetë gjuha shqipe. Çdo njëra për tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila palë do të mbajë një kopje. Dy kopjet e tjera, një e mban Noterja dhe kopja e pestë depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Shoqërive Tregëtare.

HYRJA NË FUQI E KONTRATËS


Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo Kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Unë Noterja, pasi ua lexova me zë të lartë palëve tekstin e kësaj Kontrate dhe palët më deklaruan se e kuptojnë, konstatova se ata e gjejnë atë, të rregullt në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe Unë i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Z. Artan DULAKU



BLERËSI

Shoqëria "Alissa Costruzioni" SpA

Përfaqësuar nga :

Z. Andrea Bergamin

NOTERI
Ruko SAKO



